

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË URA VAJGURE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Ura Vajgurore**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Auditim financiar*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 79, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 371/6, datë 30.06.2014, i ka rekomanduar z. Syrja Ormënaj, Kryetar i Bashkisë Ura Vajgurore, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 148/5, datë 21.05.2012, veçanërisht përsa i përket shpërblimit të dëmit në vlerën prej 736,086 lekë i krijuar si rezultat i pagesës të 13 punonjësve të emëruar “*Drejtor*”, kur duheshin emëruar “*Përgjegjës Zyre*”, veprim në kundërshtim me pikën 5, kreu III, neni 11 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, VKM nr. 693, datë 18.8.2010, për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.7.2008.

Menjëherë

2. Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren të gjitha masat që për vitet ushtrimore në vazhdim të programohet një buxhet i balancuar dhe real, duke përcaktuar saktë të ardhurat në nivel vendor, në referim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*”.

Vazhdimisht

3. Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren të gjitha masat për vjeljen nga 5 subjekte të biznesit të madh që rezultojnë të ushtrojnë aktivitetin ekonomik financiar në juridiksionin administrativo-territorial të kësaj njësie të qeverisjes vendore, por që nuk kanë paguar detyrimet financiare në vlerën **2,401,200** lekë. Ndaj 5 subjekteve të procedohet dhe me aplikimin e gjobave për mos shlyerje detyrimi në afat, në përputhje me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”.

Menjëherë

4. Nga Bashkia Ura Vajgurore në përgatitjen e projekteve e preventiva të investimeve që duhet të kryej kjo njësi e qeverisjes vendore të veprohet në zbatim të akteve ligjore rregullatore të cilat janë në fuqi në kohën e përpilimit të dokumentacionit apo në kohën e realizimit të investimit në rastet kur kryerja e këtyre dy procedurave nuk përkon në kohë apo kur nga njëra procedurë në tjetrën është konstatuar ndryshim i kuadrit ligjor të fushës.

Vazhdimisht

5. Nga Bashkia Ura Vajgurore në çdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të shqyrtohet e vlerësohet nëse nga subjekti është plotësuar kriteri ligjor i përcaktuar nga VKM nr. 480, datë 22.6.2011, lidhur me regjistrimin e infrastrukturës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Vazhdimisht

6. Nga Bashkia Ura Vajgurore të procedohet menjëherë për regjistrimin në ZVRPP Berat të të gjitha pasurive të kaluara në pronësi, sipas disponimeve të VKM-së përkatëse për inventarizimin e tyre në zbatim të VKM nr. 720, datë 30.10.2007 dhe ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*”.

Vazhdimisht

7. Nga Bashkia Ura Vajgurore të procedohet menjëherë me plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor të secilës praktike të dhënies me qira, si dhe për çdo rast që plotëson kriteret ligjore të bëhet miratimi si procedurë për dhënien me qira nga Këshilli Bashkiak.

Vazhdimisht

8. Nga Bashkia Ura Vajgurore të ndiqen me përgjegjshmëri proceset gjyqësore për secilën gjobë të vendosur për ndërtime pa leje, për ato raste kur është konstatuar se nga subjektet është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Vazhdimisht

9. Nga INUV Bashkia Ura Vajgurore të krijohet një praktikë administrimi me protokoll e akteve të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe të ankimimeve, ku të pasqyrohen të gjitha korrespondencat e mbajtura me strukturat e tjera brenda institucionit por dhe me ato jashtë tij.

Vazhdimisht

10. Nga INUV Bashkia Ura Vajgurore të krijohet një praktikë pune lidhur me hartimin e një analize vjetore për aktivitetin e kryer dhe hartimin e raporteve vjetore të aktivitetit të INUV.

Vazhdimisht

11. Nga Bashkia Ura Vajgurore, të veprohet me plotësimin e organikës së strukturës së Policisë Bashkiake, duke bërë emërimin e punonjësve të policisë, sipas nenit 11 të urdhrit të përbashkët të MPVD nr. 1530 datë 07.4.2003” dhe MRP, nr. 823 datë 11.4.2003.

Vazhdimisht

12. Nga Policia Bashkiake të merren të gjitha masat dhe të kryhen të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vleftës prej 16,000 lekë ndaj subjekteve kundërvajtësve, në zbatim të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010.

Vazhdimisht

13. Nga Bashkia Ura Vajgurore, Policia Bashkiake të veprohet për çdo rast me plane pune të planifikuara në zbatim të ligjit, si dhe të ndërmerren të gjitha masat e duhura lidhur me bashkëveprimin dhe dokumentimin e procedurave të kryera nga kjo strukturë si në bashkëpunimin rutinë me strukturat e tjera brenda komunës, ashtu dhe me institucionet e tjera jo në varësi.

Vazhdimisht

14. Nga Bashkia Ura Vajgurore, Autoriteti kontraktor, KVO por dhe NJP, për çdo rast të zhvillimit të çdo procedure prokurimi publik duhet të zbatojë kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi sipas të drejtave dhe detyrimeve të mirë përcaktuara nga LPP dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,674,065 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. Nga Bashkia Ura Vajgurore të kryhen të gjitha procedurat për arkëtimin e vleftës prej **1,588,065 lekë** pa tvsh të përfituara padrejtësisht nga firma “A...” sh.p.k. në kundërshtim me pikat 35-40 të Kreut të III të UMF nr. 30 datë 27.12.2011, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, neni nr. 8 dhe 11, me Kreun I pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Menjëherë

2. Nga Bashkia Ura Vajgurore të kryhen të gjitha procedurat për arkëtimin e vleftës prej **86,000 lekë** të përfituar nga znj. D.M. me detyrë Inspektore në Drejtorin e të Ardhurave, në kundërshtim me VKM nr. 1619 datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

C. MASA DISIPLINORE

C.I. Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “*Kodi i Punës*”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Ura Vajgurore, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim”, për:

1. M.B. me detyrë Drejtore e Financës, pasi:

Në 1 rast në shumën 86,000 lekë, janë përlogaritur gabim pagat dhe funksionet në kundërshtim me VKM nr. 1619 datë 02.7.2008 “*Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore*”, me ndryshime, pasi është paguar punonjësi i administratës të bashkisë me diplomën e arsimit Universitar “*Diplomë e Nivelit të Parë*” (DNP), ku ka përfituar pagesën për “*Diplomën e Nivelit të Dytë*” (DND), duke përfituar padrejtësisht shumën prej **86,000 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore.

Në programimin e shpenzimeve për vitin 2012, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e vitit 2011, në shumën 19,647,633 lekë, në kundërshtim me udhëzimi nr. 1 datë 21.01.2011 “*Për zbatimin e buxhetit 2011*”, pika 93.

Në programimin e shpenzimeve për vitin 2012, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e vitit 2011, në shumën 21,058 mijë lekë, në kundërshtim me udhëzimi nr. 4 datë 27.01.2011 “*Për zbatimin e buxhetit 2011*”, pika 97, ku përcakton se: “*Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj miratohen fondet për të financuar veprimtarin e vitit në vazhdim*”.

Buxheti i vitit 2012 dhe vitit 2013, është programuar i disbalancuar, në kundërshtim me neni 6, paragrafi i IV- të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetorë*”.

Nuk është bërë parashikim i realizimit të ardhurave duke dhënë ndikim në mosrealizimin e shpenzimeve dhe investimeve për vitin 2012.

Nuk ka informuar Këshillin Bashkiak, për rezultatet e inventarizimit, për vitin 2013.

2. Q.T. me detyrë Specialiste e Pagave në Drejtorinë e Financës, pasi:

Në 1 rast në shumën 86,000 lekë, ka kryer pagesat pa kontrolluar dokumentacionin, duke përlogaritur gabim pagat dhe funksionet në kundërshtim me VKM nr. 1619 datë 02.7.2008 “*Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore*”, me ndryshime, pasi është paguar punonjësi i administratës të bashkisë me diplomën e arsimit Universitar “*Diplomë e Nivelit të Parë*” (DNP), ku ka përfituar pagesën për “*Diplomën e Nivelit të Dytë*” (DND), duke përfituar padrejtësisht shumën prej **86,000 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore.

3. F.P. me detyrë Përgjegjëse Administrate, Protokoll dhe Arkivës, pasi:

Në 1 rast, ka paraqitur projekt vendimin e strukturës të pagave duke trajtuar me arsim të lartë një punonjës për të cilin rezulton se është përlogaritur gabim paga dhe funksioni në kundërshtim me VKM nr. 1619 datë 02.7.2008 “*Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore*”, me

ndryshime, pasi është paguar punonjësi i administratës të bashkisë me diplomën e arsimit Universitar “Diplomë e Nivelit të Parë” (DNP), ku ka përfituar pagesën për “Diplomën e Nivelit të Dytë” (DND), duke përfituar padrejtësisht shumën prej **86,000 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore. Nuk është zbatuar sistemi i marrjes në punë nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në meritat e secilit dhe mbas marrjes në punë për rekrutimet e reja të bëhen programe të trajnimit të tyre gjatë periudhës së provës pasi ligji i ri ka dalë por nuk kanë dalë vendimet përkatëse për zbatimin e tij.

- 4. V.S. me detyrë Kryeinspektor i Policisë Bashkiake;**
- 5. V.C. me detyrë Inspektor i Policisë Bashkiake;**
- 6. A.P. me detyrë Inspektor i Policisë Bashkiake dhe**
- 7. P.G. me detyrë Inspektor i Policisë Bashkiake, pasi:**

Policia Bashkiake nuk ka bashkëpunuar me Zyrën e Tatim/Taksave, si dhe nuk ka dokumentuar për çdo rast kontrollet e ushtruar mbi territorin nën administrim të saj për vjeljen e të ardhurave vendore pasi kjo strukturë nuk ka evidenca të subjekteve të licencuara dhe të palicencuara, për rrjedhojë, për subjektet të cilët mund të operojnë në treg të paregjistruara nuk është vepruar sipas pikës 2/a të nenit 49 “*Shkeljet dhe dënimet në lidhje me regjistrimin*” të ligjit nr. 8560 datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore” ku sanksionohet se: “*kryerja e veprimtarisë pa u pajisur më parë me certifikatën tatimore, dënohen...*”, po ashtu edhe ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar taksat brenda afatit, nuk është aplikuar gjobë në masën 20% të detyrimit të taksës, sipas kërkesave të nenit 17 pika 1/a “*Kundërvajtjet dhe sanksionet*”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i cili sanksionon se: “*mospagimi i taksës brenda afatit të caktuar dënohet me gjobë të barazvlefshme me 25 për qind të detyrimit për taksën*”.

Nuk ka mbajtur procesverbal apo dokument tjetër për evidentimin e subjekteve pa leje apo pagesën e detyrimeve fiskale, duke u mjaftuar vetëm me bërjen me dije verbalisht të subjekteve për detyrimet që kanë ndaj institucionit.

Pra, nga mos koordinimi i mirë, nuk janë evidentuar subjektet të cilat kryejnë aktivitet ekonomik të palicencuar, duke mos mundësuar kështu rritjen e subjekteve tatim paguesve, pra për rrjedhojë dhe rritjen e të ardhurave, sipas pikës 9 të nenit 8 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, i cili përcakton se Policia Bashkiake ka për detyrë të inspektojë respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjediset publike.

Nuk ka dokumentuar veprimet për parandalimin dhe masat për shmangien dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme si dhe të ndalimin e zënien e paligjshme të trojeve, ndërtesave dhe të objekteve, të kryera në bashkëpunim me Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik kur rezulton se nga INUV janë mbajtur procesverbale kontrolli dhe konstatimi edhe pse jo në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2009 “*Për inspektimin e ndërtimit*”.

Nga Policia nuk janë dokumentuar procedurat lidhur me orientimin e subjektet ndërtuese që të veprojnë në përputhje me kërkesat e nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, pra duke ju drejtuar Zyrës së Urbanistikës për pajisjen me leje zhvillimore për objektet ndërtimore.

Nga Policia Bashkiake nuk janë dokumentuar për çdo rast kontrollet e ushtruar mbi territorin nën administrim të kryera në bashkëpunim me Inspektoratin e Rendit në drejtim të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, planin e masave për kontrollin e territorit të komunës për mos kultivimin e bimëve narkotike etj, duke mos u zbatuar plotësisht detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8224, datë 15.7.1997 “*Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës*”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998, si dhe akteve nënligjore të nxjerra për dhe në zbatim të tij.

Dokumentimi i punës dhe rezultateve të saj është detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 8224, datë 15.5.1997, “*Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës*”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998, si dhe urdhri i përbashkët i Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.

1530 datë 07.4.2003” dhe Ministrisë të Rendit Publik, nr. 823 datë 11.4.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

8. M.B. me detyrë Ish-Kryeinspektor i Inspektoratit Urbanistik Vendor

Nuk kanë mbajtur një regjistër dhe një praktikë protokollimi të akteve të nxjerra gjatë veprimtarisë së INUV-it dhe të animimeve ndaj vendimeve, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” e cila përcakton se: “Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit” dhe me pikën 19 “Detyrat” të Rregullores së brendshme të njësisë vendore, pasi përdoret regjistri i protokoll arkivës së institucionit.

Nuk janë bërë analiza vjetore për aktivitetin e kryer dhe nuk janë hartuar raporte vjetore të aktivitetit të INUV-it, duke mos zbatuar pikën 5 të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” e cila përcakton se: “Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor mbi zhvillimet në territor”.

9. Q.N. me detyrë Inspektor i Inspektoratit Urbanistik Vendor pasi:

Për objektet “Rikonstruksion trotuari dhe ndriçim në rrugën Demokracia në lagjen 18 Tetori”; “Ndërtim lulishte në lagjen 18 Tetori”; si dhe “Ndërtim lulishte në lagjen 4 Shtatori”, nga ku është konstatuar se projekt preventivat e hartuar nga grupi i projektimit mbajnë datën 18.12.2011 dhe referenca e përdorur për përlllogaritjen e hartimin e këtyre preventivëve ka qenë VKM nr. 708, datë 12.10.2011 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, kur përlllogaritja e hartimi i preventivëve duhet të ishte realizuar sipas VKM nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Sa sipër nuk është zbatuar VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 2 ku përcaktohet se: “Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, ..., bëhet në përputhje me këtë vendim”, dhe pika 3 ku përcaktohet se: “Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit të çdo prokurimi, me fonde publike, në fushën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe e kontabilitetit teknik për çdo punim ndërtimi”.

Nuk kanë mbajtur një regjistër dhe një praktikë protokollimi të akteve të nxjerra gjatë veprimtarisë së INUV-it dhe të animimeve ndaj vendimeve, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” e cila përcakton se: “Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit” dhe me pikën 19 “Detyrat” të Rregullores së brendshme të njësisë vendore, pasi përdoret regjistri i protokoll arkivës së institucionit.

Nuk janë bërë analiza vjetore për aktivitetin e kryer dhe nuk janë hartuar raporte vjetore të aktivitetit të INUV-it, duke mos zbatuar pikën 5 të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” e cila përcakton se: “Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor mbi zhvillimet në territor”.

10. B.S. me detyrë Inspektor i Zyrës së të Ardhurave Vendore;

11. D.M. me detyrë Inspektor i Zyrës së të Ardhurave Vendore dhe

12. S.D. me detyrë Inspektor i Zyrës së të Ardhurave Vendore, pasi:

Për mos pagimin e detyrimeve nga 5 subjekte të mëdha në vlerën **2,401,200** lekë, ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar në afat, si dhe për mos aplikimin e masës ndëshkimore më gjatë nda këtyre subjekteve, mosveprim ky në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *”Për Procedurat Tatimore”*.

Ka munguar bashkëpunimi i dokumentuar në lidhje me inventarizimin e plotë të listave të mjeteve të transportit në pronësi të qytetarëve sipas llojit të tyre, targave, tonazhit, në kundërshtim me udhëzimin e përbashkët të MPVD dhe MF nr. 9, datë 04.02.2003 *”Për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit”*. Ndërkohë nuk janë hartuar akt akordimet me Degën e Shfrytëzimit të Automjeteve Berat.

Mbyllja e aktivitetit të subjekteve është pranuar gjithnjë mbi bazën e kërkesës së subjektit, pa u konfirmuar nga Policia e bashkisë, por nga vetë Drejtoria e të Ardhurave. Mbyllja e aktivitetit nga firmat e gurores nuk është shoqëruar me ekstraktin e QKR (në 2 raste).

Kontrollet nuk kanë qenë në nivelin e duhur, nuk është bashkëpunuar me sektorin e Financës për të dhënat që realizojnë subjektet nga blerjet në vlera të vogla, apo shërbimet e ndryshme.

Nuk është parashikuar dhe realizuar asnjë kontroll në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe të dokumentuara me procesverbale pothuajse mungojnë.

Në asnjë rast nuk është bërë rivlerësim në rritje apo ulje i subjekteve të cilët kanë tejkaluar apo nuk kanë realizuar xhiron e deklaruar, bazuar në nenin 4, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *”Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar dhe nenet 68 dhe 70/3 *”Vlerësimi tatimor”*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *”Për Procedurat tatimore”*.

Vendosja e Kasave Fiskale është formale pasi subjektet nuk i përdorin ato duke mos i shërbyer qëllimit për pasqyrimin e xhiros dhe pagesës së detyrimeve fiskale.

Nuk janë ushtruar kontrole për mbajtjen e saktë të librave, mbajtjen e xhiros, bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *”Për sistemin e taksave vendore”*, edhe ato pak kontrole që pretendohet të jenë kryer nuk janë dokumentuar dhe shoqëruar me program kontrolli apo akt verifikimi, gjë që i bën ato të pavlefshme, në kundërshtim me pikën 10-Kontrolli tatimor, të UMF nr. 655/1, datë 06.02.2007 *”Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”*.

Nuk kanë planifikuar të ardhura nga ndotje e ambientit ndaj kompanive të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës për vitin 2012 dhe 2013.

Nuk ka planifikuar të ardhura nga shërbimi veterinar, kjo tregon që nga ana e drejtorisë të të ardhurave nuk është bërë një planifikim real, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *”Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar neni 35 i tij *”Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”*.

Programimi, planifikimi dhe funksionimi i tarifës së tregut privat për vitin 2013 nuk ka pasur efektivitetin e duhur duke u mbështetur në të dhënat me vitin e kaluar (2012) dhe nga ana e zyrës së tatim taksave dhe komisionit të caktuar për mbledhjen e kësaj tarife nuk ka një plan vendosje ku të jenë përcaktuar hapësirën që ka ky treg.

Nga ana e zyrës së transportit në bashkëpunim me zyrën e tatim taksave të bashkisë, për vitin 2012 dhe 2013 nuk janë evidentuar mjete të transportit që qarkullojnë pa licencë.

13. P.S. me detyrë Veteriner, Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit, pasi:

Nga auditimi i ushtruar dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatuan se për vitin 2013 në bazë të regjistrimit dhe raporteve të therjeve janë arkëtuar 288,200 lekë, u konstatua se të ardhurat nga kjo taksë nuk ishin planifikuar. Mos planifikimi i të ardhurave nga therjet të cilat janë evidente në çdo kohë është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *”Për sistemin e taksave vendore”* neni 35 *”Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”*, dhe tregon për një planifikim jo real të saj.

14. R.P. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, shërbimeve Publike dhe Strehimit dhe

15. H.A.me detyrë Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, shërbimeve Publike dhe Strehimit, pasi:

Për objektet “Rikonstrukcion trotuari dhe ndriçim në rrugën Demokracia në lagjen 18 Tetori”; “Ndërtim lulishte në lagjen 18 Tetori”; si dhe “Ndërtim lulishte në lagjen 4 Shtatori”, nga ku është konstatuar se projekt preventivat e hartuar nga grupi i projektimit mbajnë datën 18.12.2011 dhe referenca e përdorur për përllogaritjen e hartimin e këtyre preventivëve ka qenë VKM nr. 708, datë 12.10.2011 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, kur përllogaritja e hartimi i preventivëve duhet të ishte realizuar sipas VKM nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Sa sipër nuk është zbatuar VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 2 ku përcaktohet se: “Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, ..., bëhet në përputhje me këtë vendim”, dhe pika 3 ku përcaktohet se: “Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit të çdo prokurimi, me fonde publike, në fushën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe e kontabilitetit teknik për çdo punim ndërtimi”.

C.II. Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Ura Vajgurore, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

“Ndërprerje e kontratës së marrëdhënies së punës”, për:

- 1. R.Sh. me detyrë NënKryetare e Bashkisë në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave**
- 2. N.Xh. me detyrë anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave**
- 3. V.J. me detyrë Drejtor e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, shërbimeve Publike dhe Strehimit, pasi:**

Në prokurimin me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”, me procedure kërkesë për propozime është kryer 4 herë për periudhën 2012-2013 dhe një herë për vitin 2011 dhe në asnjë rast nga ana e AK nuk është lidhur kontratë por pastrimi i qytetit është kryer me tre shtesa kontratash të lidhura me firmën “A...” sh.p.k, veprim ky në kundërshtim me germën a,b të nenit 33 të ligjit nr. 9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si dhe me germën b, pika 5 Kreu IV të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar.

Në prokurimin me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”, procedura e parë e dytë dhe e tretë, rezulton se nga KVO janë skualifikuar padrejtësisht OE “K...” sh.p.k. dhe “H...” sh.p.k, kur nga dokumentacioni rezulton se plotësojnë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet standarde nga NJP. Skualifikimi i OE është në kundërshtim me nenin 2, parimet e përzgjedhjes nenin 45, kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve, nenin 46, kualifikimi i ofertuesve dhe nenin 47, skualifikimi i ofertuesve të LPP.

Në prokurimin me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”, procedura e katërt, rezulton se nga KVO janë skualifikuar padrejtësisht OE “K...” sh.p.k. dhe “H...” sh.p.k, kur nga dokumentacioni rezulton se plotësojnë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet standarde nga NJP. Skualifikimi i OE është në kundërshtim me nenin 2,

parimet e përzgjedhjes nenin 45, kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve, nenin 46, kualifikimi i ofertuesve dhe nenin 47, skualifikimi i ofertuesve të LPP.

Në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, procedura e katërt, rezulton se nga KVO dhe Titullari i AK është kualifikuar e shpallur fitues OE “T&T...” shpk, kur ky subjekt nuk përmbushte kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga NJP, Skualifikimi i OE, në kundërshtim me nenin 2, parimet e përzgjedhjes nenin 45, kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve, nenin 46, kualifikimi i ofertuesve dhe nenin 47, skualifikimi i ofertuesve të LPP.

Titullari i AK në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, nuk ka zbatuar vendimin e KPP 54/3 datë 14.02.2013 i cili ka vendosur për:

1. Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “H...”

2. Autoriteti Kontraktor të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke skualifikuar bashkimin e operatorëve “T&T...” dhe “R...”, si dhe

Nuk ka marrë për bazë shkresën e KPP nr. 54/6, datë 12.03.2013 për zbatimin e vendimit nr. 54/3 datë 14.02.2013, veprime në kundërshtim me nenin 64 të LPP.

Titullari i AK për shërbimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, edhe pse kishte kryer më parë një procedurë prokurimi, ka realizuar shërbimin duke nënshkruar kontratë me një tjetër operator ekonomik “A...” sh.p.k, pa asnjë lloj procedure prokurimi, në kundërshtim me LPP.

Titullari i AK për shërbimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, në vitin 2014 ka zhvilluar një tjetër procedurë prokurimi me objekt: *“Marrje me qira të mjetit teknologjik”*, duke vijuar me moszbatimin e vendimit të KPP nr. 54/3 datë 14.02.2013 për lidhjen e kontratës me operatorin “H...” sh.p.k. edhe pse akti është administrativisht i zbatueshëm, veprim ky që bie ndesh me nenin 64 të LPP.

Në cilësinë e hartueses së preventivit të prokurimit *“Shërbimi i pastrimit të qytetit”* janë konstatuar pasaktësi të sipërfaqeve të rrugëve dhe shesheve që janë paguar për fshirje me krahë dhe larje me mjet, me diferencë të sipërfaqes të rrugëve me 10,525 m² dhe një diferencë prej 2,615 m² për rrugët që janë parashikuar për tu larë, duke favorizuar firmën “A...” sh.p.k. e cila ka përfituar padrejtësisht shumën 1,588,065 lekë pa tvsh. Veprime në kundërshtim me pikat 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40 të Kreut të III-të të UMF nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”, të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni nr. 8 dhe 11, me Kreun I- rë pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Për objektet *“Rikonstruktion trotuari dhe ndriçim në rrugën Demokracia në lagjen 18 Tetori”*; *“Ndërtim lulishte në lagjen 18 Tetori”*; si dhe *“Ndërtim lulishte në lagjen 4 Shtatori”*, nga ku është konstatuar se projekt preventivat e hartuar nga grupi i projektimit mbajnë datën 18.12.2011 dhe referenca e përdorur për përlllogaritjen e hartimin e këtyre preventivëve ka qenë VKM nr. 708, datë 12.10.2011 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*, kur përlllogaritja e hartimi i preventivëve duhet të ishte realizuar sipas VKM nr. 407, datë 27.6.2012 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*. Sa sipër nuk është zbatuar VKM nr. 514, datë 15.8.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*, pika 2 ku përcaktohet se: *“Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, ..., bëhet në përputhje me këtë vendim”*, dhe pika 3 ku përcaktohet se: *“Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit të çdo prokurimi, me fonde publike, në fushën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe e kontabilitetit teknik për çdo punim ndërtimi”*.

Në lidhje me shqyrtimin e lejeve të përdorimit nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, edhe pse rezultoi se dosjet e objekteve për të cilat janë dhënë lejet e përdorimit në përgjithësi janë të plota si nga ana e dokumenteve ligjore dhe ato teknike, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 480, datë 22.6.2011, *“Për miratimin e rregullores model të planifikimit”* e ndryshuar, neni 10 *“Kushtet për zhvillim”*, pika 11 e cila përcakton se: *“Infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri dhe e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi”*, pasi nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Berat.

4. E.Gj.me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik në periudhën 2012-2013 dhe Jurist i Njesisë së Prokurimit, pasi:

Në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, me procedure kërkesë për propozime është kryer 4 herë për periudhën 2012-2013 dhe një herë për vitin 2011 dhe në asnjë rast nga ana e AK nuk është lidhur kontratë por pastrimi i qytetit është kryer me tre shtesa kontratash të lidhura me firmën *“A...”* sh.p.k, veprim ky në kundërshtim me germën a,b të nenit 33 të ligjit nr. 9643 datë 20.12.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar si dhe me germën b, pika 5 Kreu IV të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* të ndryshuar.

Në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, procedura e parë e dytë dhe e tretë, rezulton se nga KVO janë skualifikuar padrejtësisht OE *“K...”* sh.p.k. dhe *“H...”* sh.p.k, kur nga dokumentacioni rezulton se plotësojnë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet standarde nga NJP. Skualifikimi i OE është në kundërshtim me nenin 2, parimet e përzgjedhjes nenin 45, kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve, nenin 46, kualifikimi i ofertuesve dhe nenin 47, skualifikimi i ofertuesve të LPP.

Në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, procedura e katërt, rezulton se nga KVO janë skualifikuar padrejtësisht OE *“K...”* sh.p.k. dhe *“H...”* sh.p.k, kur nga dokumentacioni rezulton se plotësojnë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet standarde nga NJP. Skualifikimi i OE është në kundërshtim me nenin 2, parimet e përzgjedhjes nenin 45, kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve, nenin 46, kualifikimi i ofertuesve dhe nenin 47, skualifikimi i ofertuesve të LPP.

Në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, procedura e katërt, rezulton se nga KVO dhe Titullari i AK është kualifikuar e shpallur fitues OE *“T&T...”* shpk, kur ky subjekt nuk përmbushte kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga NJP, Skualifikimi i OE, në kundërshtim me nenin 2, parimet e përzgjedhjes nenin 45, kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve, nenin 46, kualifikimi i ofertuesve dhe nenin 47, skualifikimi i ofertuesve të LPP.

Titullari i AK në prokurimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, nuk ka zbatuar vendimin e KPP 54/3 datë 14.02.2013 i cili ka vendosur për:

1. Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik *“H...”*

2. Autoriteti Kontraktor të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke skualifikuar bashkimin e operatorëve *“T&T...”* dhe *“R...”*, si dhe

Nuk ka marrë për bazë shkresën e KPP nr. 54/6, datë 12.03.2013 për zbatimin e vendimit nr. 54/3 datë 14.02.2013, veprime në kundërshtim me nenin 64 të LPP.

Titullari i AK për shërbimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, edhe pse kishte kryer më parë një procedurë prokurimi, ka realizuar shërbimin duke nënshkruar kontratë me një tjetër operator ekonomik *“A...”* sh.p.k, pa asnjë lloj procedure prokurimi, në kundërshtim me LPP.

Titullari i AK për shërbimin me objekt *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Ura Vajgurore”*, në vitin 2014 ka zhvilluar një tjetër procedurë prokurimi me objekt: *“Marrje me qira të mjetit teknologjik”*, duke vijuar me moszbatimin e vendimit të KPP nr. 54/3 datë 14.02.2013 për lidhjen e kontratës me operatorin *“H...”* sh.p.k. edhe pse akti është administrativisht i zbatueshëm, veprim ky që bie ndesh me nenin 64 të LPP.

Pasi pas dështimit më datë 29.12.2011 të procedurave të prokurimit *“Shërbimi i pastrimit të qytetit”*, për mungesë operatorësh është lidhur një kontratë shtesë në datën 30.12.2011 për pastrimin e qytetit me firmën *“A...”* sh.p.k. por pa reflektuar në këtë kontratë shtesë ndryshimet e sipërfaqeve të pasqyruara në materialet e publikuara për tenderin e pastrimit të datës 29.12.2011 dhënë nga drejtoria e planifikimit të territorit dhe shërbimeve dhe të miratuara nga njësia e prokurimit. Diferenca e sipërfaqes ($80000\text{ m}^2 - 75068\text{ m}^2 = 4932\text{ m}^2$) prej 4932 m^2 duhej të pasqyrohej në lidhjen e kontratës shtesë.

Pasi me mbarimin e afatit të përfundimit të shtesës së kontratës datë 30.06.2012, bashkia ka *rilidhur një shtesë kontratë* sipërmarrje po me të njëjtin operator e cila daton 02.07.2012, për pastrimin e qytetit nga firma *“A...”* sh.p.k., me afat kohor deri në datën 31.12.2012.

Përsëri bashkia ka *rilidhur një shtesë kontratë me nr. 615 prot. datë 31.12.2012* duke zgjatur afatin e kryerjes së shërbimit.

Duke përcaktuar se firma *“Albano”* sh.p.k. do të vazhdojë kryerjen e shërbimit të pastrimit të qytetit deri në momentin e lidhjes të kontratës së re, me operatorin fitues.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me germën *“a”* dhe *“b”* të nenit 33 të ligjit 9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar, si dhe germën *“b”*, pika 5, të kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* të ndryshuar.

Në lidhjen e kontratave të qirasë, rezulton se nuk janë zbatuar kriteret dhe procedurat e VKM nr. 529, datë 08.06.2011 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”* dhe konkretisht: Kreut II *“Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”*, pika 1 gërmat *“a”*; *“b”*, *“c”* dhe *“ç”*; pika 3 *shkronjën “a”*; Kreu VI *“Monitorimi i Kontratave”*, pikat 1 dhe 2, si dhe nënpikat 2/a, 2/b, 2/c, 2/ç dhe 28/d, lidhur me dorëzimin e objektit sipas kontratës; hartimit të procesverbalit përkatës të dhënies por dhe marrjes në dorëzim; ndjekjen në vijimësi mbi respektimin e kushteve të kontratës; si dhe dërgimin e të dhënave degës së shoqërive publike pranë prefekturës dhe dërgimin e informacionit mbi ecurinë dhe konfirmimin e arkëtimeve.

Pronat e dhëna me qira nuk figurojnë të regjistruar në ZVRPP Berat, si dhe nuk evidentohet se me çfarë VKM-je dhe kujt numri rendor apo pasuror i korrespondon kalimi në pronësi apo përdorim të Bashkisë, në kundërshtim me kreun IV nenin 13, neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, dhe me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, si dhe në kundërshtim me nenin 678 të Kodit Civil dhe ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, i ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, pasi janë marrë attribute të cilat ligji ja ka njohur posaçërisht Këshillit të Bashkisë dhe konkretisht: neni 6 *“Organet e njësive të qeverisjes vendore”* pika 2; neni 8 *“Të drejtat e njësive të qeverisjes vendore”*, pika 1.II.a dhe c; neni 32 *“Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak”* pika e *“Këshilli komunal ose bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca”*; si dhe neni 44 *“Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të komunës ose të bashkisë”*, pika a *“Kryetari i komunës ose bashkisë”: a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës.*

D. MASA ADMINISTRATIVE

Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu III-të *“Sanksionet”* nenet 15 e 16, t'i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë gjobë për ing. P.Ç.** për shkeljet e

konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt “*Shërbimi i pastrimit të qytetit*”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik buxhetit të njësisë vendore në shumën 1,588,065 lekë pa tvsh, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punë të pakryer, si pasojë e pasaktësive të sipërfaqeve të rrugëve dhe shesheve që janë paguar për fshirje me krahë dhe larje me mjet, me diferencë të sipërfaqes të rrugëve me 10,525 m² dhe një diferencë prej 2,615 m² për rrugët që janë parashikuar për tu larë, veprime në papajtueshmëri me nenin 8 dhe 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Kreun I- rë pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

F. KALLZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 371/7, datë 31.12.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat:

R.Sh. në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

V.J. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

N.Xh. me detyrë anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

E.Gj. në cilësinë e Juristit dhe anëtarit të Njesisë së Prokurimit Publik dhe

I.B. në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Nga Bashkia Ura Vajguore me shkresë nr.355, prot, datë 18.07.2014, protokolluar në KLSH me nr.371/9 datë 24.07.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar po pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Piro Imeraj, Ryisim Xhaja dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT